

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, i përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarës A. H. nga Fshati M., K. P., për shkak të veprës penale Shpërdorimi nga neni 330 par .5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2274/14 të dt. 10.03.2015, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik më dt.20.07.2017, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Enver Krasniqi dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 27.07.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara,

A. H., me nofken B. nga i ati A. dhe e ëma E., e vajzërisë H., e lindur më *data e lindjes...*, në fshatin M., tani me vendbanim në fshatin B., K. P., me nr. personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e martuar nënë e 1 (një) fëmiju, e gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë e gjykuar më parë dhe ndaj saj nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptare-Kosovare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse:

Me datën 20.12.2013, rreth orës 15:10, në rrugën "...", në shkollën e mesme "I. B.", në P., me qëllim që vetës apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme ka përvetësuar sendin e huaj të luajtshëm të cilin e ka gjetur apo rastësisht i ka rënë në dorë ashtu që telefonin e tipit Samsung, ngjyrë e bardhë, pronë e të dëmtuarës A. G. e ka gjetur në tualetin e shkollës dhe të njëjtin e ka marr me qëllim përvetësimi.

-Me këtë ka kryer veprën penale Shpërdorimi nga neni 330 par. 5 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 41, 85, 86 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe 498 të KPPRK-së, të akuzuarës i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Me këtë vërejtje gjyqësore të akuzuarës **A. H.**, i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale-paushallit gjyqësor shumë prej **30.00€**, të gjitha këto brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuara A. G., nga fshati M., Komuna e Podujevës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.2274/14 të dt. 10.03.2015, kundër të akuzuarës A. H. nga Fshati M., K. P.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 20.07.2017, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe e akuzuara A. H.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga e akuzuara dha mendimin duke deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë së të pandehurës, sepse është konform dispozitave të neni 248 të KPPRK-së.

E akuzuara në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, për herë të parë kam rënë ndesh me ligjin dhe i premtom gjykatës se më nuk do ta përsëris.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarës, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së neni 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform neni 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet e akuzuara, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarës A. H., përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale

Shpërdorimi nga neni 330 par. 5 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se e akuzuara në aspektin penalo-juridik është përgjegjëse dhe të njëjtën e shpalli fajtores, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, e në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti se gjatë shqyrtimit fillestar e akuzuara e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për herë të parë ka ardhur në kundërshtim me ligjin, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, duke u bazuar në të njëjtën dispozitë ligjore si dhe në dispozitat e neneve 4, 41, 85, 86, neni 330 par. 5 të KPRK-së, gjykata vlerësoi se me një vërejtje gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 dhe 3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.234/2015, dt.27.07.2017

Sekretare Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.